



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1129/4 Prot.

Tiranë, më 05 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 175 , datë 05 . 08 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 170 Regj., datë 28.07.2025, të shtetasit I. L, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, subjekti ankues, z. I. L, parashtron, ndër të tjera, se:

Me urdhrin nr. 135, datë 18.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është liruar nga detyra me kërkesën e tij.

Pas lirimit, ankuesi shprehet se, në mbështetje të nenit 117, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ka ushtruar të drejtën e tij ligjore përmes paraqitjes së kërkesës për rikthimin në Polici.

Fillimisht i është drejtuar organit kompetent në muajin dhjetor, dhe, nëpërmjet shkresës me nr. 150 prot., datë 31.12.2024, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNJ), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) i është refuzuar kërkesa.

¹ Duke klasifikuar veten tek grupimi (duke cituar ankuesin) “*jo punonjës nga radhët e policë/jo punonjës në detyrë*”.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Në vijim ankuesi ka dërguar kërkesë tjetër me datë 29.01.2025, në përgjigje të së cilës, është informuar nga DBNJ, (me shkresën me nr. 102/1 prot., datë 20.02.2025), se nuk ka vende të lira.

Ankuesi shprehet se është ankuar në instancat përkatëse të DPPSH-së, si edhe tek Ministri i Brendshëm, dhe se për disa nga kërkesat e tij ende nuk ka marrë përgjigje zyrtare.

Më tej, ankuesi citon se: *“Me Urdhrin nr. 831, datë 09.06.2025, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ka shpallur thirrjen për konkurim për pozicionin “Shef komisariati”, në Policinë e Shtetit.*

Në këtë Urdhër janë shpallur 6 (gjashtë) vende të lira në 6 (gjashtë) komisariate të ndryshme. Afati i paraqitjes së aplikimeve ka qenë nga data 10 qershor deri në datën 18 qershor 2025.

E gjithë kjo procedurë konkurimi, nga momenti i shpalljes së vendeve vakante e deri në emërimin e aplikantëve fitues, parashiikohet në mënyrë të detajuar në nenet 29-49, të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 112/2025.

Kam dorëzuar kërkesën për të konkuruar për njërin nga vendet vakante të shpallura, pasi përputhej edhe me gradën që mbaj, si dhe me rekomandimin që më jepej në shkresën me nr. 355/1 prot., datë 05.05.2025. Çuditërisht, me shkresën me nr. 102/7 prot., datë 18.06.2025, DBNJ, më njofton se jam skualifikuar nga gara, për shkak se unë jam i liruar dhe se mund të konkurojnë në këto vende, vetëm ata punonjës poliice në detyrë, konform neneit 62, të ligjit 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

....

Në rastin tim, mua më refuzohet kthimi në polici edhe kur hapen garat për konkurim, edhe kur bëj kërkesë individuale kur nuk ka gara të shpallura nga organi kompetent. Nuk më japin informacion për vendet vakante dhe as më japin informacion nëse janë rikthyer në polici punonjës me gradën që unë mbaj.”

Në përfundim të ankesës së tij, z. L kërkon nga Komisioneri: *“Konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rivendosjen e së drejtës së shkelur për rikthimin tim në polici, pasi jam i bindur që ka vende të lira me gradën që unë mbaj. Nëse në momentin e shqyrtimit të kësaj ankese nuk ka vende të lira, të lejohen në të ardhmen të konkuroj i lirë me punonjësit e policisë që janë në detyrë për vendet që shpallet gara apo për vendet që janë të lira dhe nuk shpallet garë.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen*

civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur dhe pretendimet e ngritura nga pala ankuuese, Komisioneri vlerëson se, ankesa e paraqitur nga z. I. L nuk mund të pranohet dhe t’i nënshtrohet shqyrtimit të mëtejshëm nga Komisioneri, pasi objekti dhe kërkitimi i saj nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit, bazuar në arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari; pala ankuuese në ankesën objekt shqyrtimi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij si pjesë e grupit të personave “jo punonjës nga radhët e policë/jo punonjës në detyrë”, duke pretenduar se duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë me punonjësit e policisë që janë në detyrë, lidhur me konkurimin për vendet e lira të shpallura, pasi cenohet e drejta e tij për t’u rikthyer në polici, për vendet e shpallura për pozicionin “Shef komisarati”.

Ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 62 dhe 117, të tij, sanksionon si vijon:

Neni 62 - Shefi i komisarati, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të lirimimit dhe të shkarkimit të tij

1. Shefi i komisarati të policisë është drejtues i nivelit operacional në territorin që mbulon dhe përgjigjet te drejtori i policisë vendore për rendin e sigurinë publike në juridiksionin e komisarati të policisë.

2. Shefi i komisarati të policisë:

a) drejton veprimtarinë e strukturave në varësi;

b) menaxhon burimet njerëzore në varësi;

c) menaxhon buxhetin e komisarati;

ç) nxjerr akte të përcaktuara në rregulloren e Policisë.

d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore brenda juridiksionit dhe të fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.

3. Shefi i komisarati përzgjidhet me konkurrim nga radhët e rolit të parë drejtues nëse plotëson njëkohësisht kriteret si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
 - b) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;
 - c) të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.
4. Kriteret e emërimit, të lirit, të shkarkimit dhe procedurat e përzgjedhjes së shefit të komisariatit të policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë.

Neni 117 - Rikthimi në Policinë e Shtetit

1. Një person rikthehet në Polici kur nuk ekziston më pengesa ligjore, e përcaktuar në shkronjat “b” deri në “ë” të pikës 2 të nenit 116, për lirin e tij.
2. **Rikthimi në Policinë e Shtetit bëhet me konkurrim dhe vetëm kur për grada të caktuara ka akoma kuota të lira.**
3. Personi që rikthehet në Policinë e Shtetit brenda një periudhe 2-vjeçare emërohet në funksione me gradën që ka pasur në kohën e lirit. Personi që rikthehet pas kalimit të afatit 2-vjeçar i nënshtrohet konkurrimin për certifikimin e njohurive dhe emërohet në funksione që i korrespondojnë një grade më të ulët sesa grada që ka pasur në kohën e lirit. Përfundimisht, pavarësisht kalimit të afatit 2-vjeçar, personi rikthehet në funksione me gradën që ka pasur në kohën e lirit kur punonjësi i policisë është larguar për shkak të dorëheqjes dhe legjislacioni i posaçëm që rregullon marrëdhëniet e punës i njeh të drejtën të rikthehet në funksione me gradën që ka pasur në kohën e lirit.
4. Punonjësi i policisë i përjashtuar nuk rikthehet në Policinë e Shtetit, përveç rasteve kur gjykata në vendimin e saj shpreh për rikthimin e tij në detyrë.

Referuar dispozitave të mësipërme ligjore, një ndër kriteret për emërimin e “Shefit të komisariatit të Policisë” është që, ai *përzgjidhet me konkurim nga radhët e rolit të parë drejtues*, nëse plotëson dhe kriteret e tjera.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, shprehja *"nga radhët e rolit të parë drejtues"* në kuptimin ligjor, sipas ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, i referohet personave që janë **punonjës të emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit**, të cilët kanë përfunduar arsimin ose kualifikimin përkatës dhe mbajnë një gradë policore përkatëse.

Në kushtet aktuale, ankuesi ka pengesë ligjore për të konkuruar e për t’u përzgjedhur në pozicionin “Shef komisariati, pasi sipas nenit 62/3, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, kushti primar dhe themelor për të konkuruar për një pozicion të tillë është qenia e konkurentit/konkurentëve pjesë e radhëve të rolit të parë drejtues në Policinë e Shtetit, kriter të cilin ankuesi nuk e përmbush, pasi ai aktualisht është jashtë radhëve të Policisë së Shtetit.

Në nenin 65, pika 3³, e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, përcaktohen gradat për punonjësit në rolin e parë drejtues. Në këtë kuptim, ankuesi duhet të ishte ushtrues efektiv në

³ 3. Gradat për punonjësit në rolin e parë drejtues janë:

a) nënkomisar; b) komisar; c) kryekomisar

një nga funksionet që përputhen me gradat e rolit të parë drejtues, për të konkuruar për pozicionin “Shef komisariati”.

Në këtë kontekst, ky togfjalësh përdoret për të treguar se një individ është *pjesë e trupës së Policisë së Shtetit*, pra është në marrëdhënie pune aktive me këtë institucion dhe ushtron funksione sipas detyrës së tij. (Punonjësit dhe Drejtuesit në nivele të ndryshme hierarkike brenda Policisë së Shtetit)

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, një punonjës policie që është larguar me dorëheqje vullnetare dhe dëshiron të rikthehet në Policinë e Shtetit në pozicionin “Shef komisariati”, duhet të ndjekë një procedurë të rregulluar me ligj dhe akte nënligjore, e cila përcakton se, rikthimi në detyrë pas dorëheqjes nuk është automatik, por mund të ndodhë vetëm nëse personi plotëson kriteret ligjore dhe procedurat e përzgjedhjes.

Në rastin konkret, të konkurimit të ankuesit për pozicionin “Shef komisariati”, sipas shpalljes së bërë me Urdhrin nr. 831 prot., datë 09.06.2025, për pozicionet “Shef komisariati”, ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, parashikon që kandidati duhet të jetë *“nga radhët e rolit të parë drejtues”/Policisë, që do të thotë se duhet të jetë punonjës aktiv në strukturat e Policisë së Shtetit.*

Në këto kushte, dispozitat konkrete ligjore janë të qarta dhe nuk lënë shteg për interpretim, një ish-punonjës policie, që është larguar me dorëheqje vullnetare nuk konsiderohet më “nga radhët e Policisë”, dhe për rrjedhojë nuk mund të kandidojë direkt për pozita drejtuese si “Shef komisariati”. Për të pasur të drejtë kandidimi, ai duhet të rikthehet më parë në shërbim aktiv, përmes një procedure të mirëpërcaktuar rikthimi, dhe më pas të konkurojë si pjesë e trupës aktive.

Pra, pengesa që has ankuesi, është pengesë ligjore dhe ka të bëjë me parashikimin ligjor, me dispozitën konkrete, e cila ndalon që ai të konkurojë për pozicionin “Shef komisariati”, përsa kohë që nuk është rikthyer fillimisht në shërbimin aktiv dhe të jetë punonjës aktiv në strukturat e Policisë së Shtetit.

Pra, diferencimin që ankuesi ka pretenduar si diskriminues para KMD-së, mes punonjësve që janë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit dhe atyre që janë dorëhequr vullnetarisht dhe nuk janë punonjës nga radhët e policë/punonjës në detyrë, e bën vetë dispozita ligjore. (Neni 62/3, i ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” përcakton se: *“Shefi i komisariatit përzgjidhet me konkurrim nga radhët e rolit të parë drejtues...”*)

Parimi i shtetit të së drejtës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre.

Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat

kushtetuese dhe ligjore (*shih Vendimin nr. 15, datë 15.04.2010, vendimin nr.22, datë 24.04.2015, vendimin nr. 2 datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007, nr. 11, datë 02.04.2008, vendimi nr. 25, datë 05.12.2008*).

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. (Neni 124, i Kushtetutës).

Në referim të neni 131, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, është institucioni i cili vendos në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një institucion i ngarkuar nga ligji për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. (neni 21, i LMD)

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit (neni 22, i LMD), ndërsa kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohen nga neni 32, i LMD.

Në këtë mënyrë, baza dhe kufiri në ushtrimin e kompetencave për Komisionerin, janë Kushtetuta dhe ligjet në fuqi. Komisioneri ka kompetencë që të shqyrojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar; të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes legjitim, qoftë kur ato pretendojnë diskriminim në emër të një individi ose grupeve të individëve, ashtu edhe kur pretendojnë diskriminim që lidhet me interesa kolektive; të kryejë hetime kryesisht pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; por në çdo rast, ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Pretendimi se një dispozitë ligjore vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, është në thelb një pretendim se ligji (*dispozita konkrete, në rastin në fjalë neni 62, pika 3, e ligjit nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit"*) nuk është në përputhje me Kushtetutën. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vëren se, gjykimin dhe vlerësimin për një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese, si i vetmi autoritet i autorizuar nga Kushtetuta për të vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, marrja në shqyrtim e një pretendimi për antikushtetueshmëri të një dispozite ligjore me Kushtetutën apo vlerësimi nëse një ligj apo dispozitë e tij, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një kompetencë që Kushtetuta i'a ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe se asnjë institucion tjetër shtetëror, përfshi edhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili nuk mund të

marrë në shqyrtim një çështje, për të cilën nuk ka kompetencë dhe kur shqyrtimi i kësaj çështje është në kompetencën e një tjetër institucioni⁴.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”, Komisioneri arrin në përfundimin se, nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e këtij kërkitimi dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtuar shqyrtimit të mëtejshëm.

Në bazë të nenit 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, parashikohet:

“1. *Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: i) individëve;*

2. *Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*”.

Pala ankuese, si një prej subjekteve të parashikuara sa më sipër, me interes individual të drejtpërdrejtë, në bazë të dispozitave të mësipërme kushtetuese mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për të vlerësuar dhe vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit në fjalë me Kushtetutën.

- **Ndërsa, sa i takon pretendimit të ankuesit, (që nuk lidhen me aplikimet e tij, për pozicionin “Shef komisariati”) lidhur me rikthimin e tij në Policinë e Shtetit,**

Komisioneri konstaton se, rikthimi bëhet sipas përcaktimit ligjor, konkretisht nenit 117/2, të e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ***vetëm me konkurim dhe vetëm kur për grada të caktuara ka akoma kuota të lira.***

Pra, bazuar në sa më sipër, ankuesi, nuk ka depozituar fakte e prova që ka pasur realisht dhe konkretisht vende të lira, të shpallura e për të cilat ai ka aplikuar dhe është refuzuar.

Nga përgjigjet shkresore të DBNJ/DPPSH, ankuesi është informuar se në momentin që ai ka paraqitur ankesën nuk mund të rikthehej për shkak të mungesës së funksioneve të lira organike, në raport me karrierën dhe gradën që ai mban.

Ankuesi nuk ka provuar të kundërtën, se për cilin vend ka aplikuar specifikisht, pasi pretendimi i tij se, institucioni nuk duhet të ngarkojë atë “të gjejë vendin” nuk qëndron, pasi, Komisioneri vëren se, detyrimi i instituconit është që të gjitha pozicionet e lira për punonjësit e Policisë së Shtetit, t’i shpallë në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dhe më tej, mbetet në vullnetin dhe dëshirën e personit të interesuar nëse do të aplikojë, konkurojë apo jo. (duke vlerësuar dhe kërkesat respektive të pozicioneve të shpalluar dhe të faktit nëse plotësohen nga personi i interesuar).

⁴ Për analogji citojmë Vendimin nr. 160, datë 10.08.2023 dhe Vendimin nr. 239, datë 30.11.2023, të Komisionerit.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, mënyra e vetme që ankuesi të rikthehet në Policinë e Shtetit është *vetëm përmes konkurimit dhe vetëm kur për gradën e tij ka kuota të lira (të shpallura)*.

- **Lidhur me pretendimin për moskthimin e përgjigjes apo mosmarrjes së informacioneve përkatëse (nëse janë rikthyer në Polici punonjës me gradën që ankuesi mban), nga institucionet respektive;**

Ky kërkim i z. I. L nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi Komisioneri vëren se, ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, sa i takon pretendimit të tij për mosdhënie të informacionit e dokumentacionit të kërkuar në mënyrë të plotë.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesi mund t'i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me Nr. 170 Regjistri, datë 28.07.2025, të paraqitur nga z. I. L, pasi nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, sipas ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA